



BASHKIA
TIRANË

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë subjektet e interesuar se në mbështetje të ligjit nr. 107/2014 datë 31.07.2014 për “Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” (i ndryshuar), akteve nënligjore në zbatim të tij dhe në zbatim të vendimit nr. 9 dt 17.02.2016 të KKT-së për “Zbatimin e Planeve të Përgjithshme Vendore nga autoritetet vendore të zhvillimit të territorit” (i ndryshuar), ju informojmë se:

Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, ka nisur hartimin për ndryshimin e fazës së parë të nën-njesisë strukturore 5/28 dhe fazat e dyta të Planeve të Detajuara Vendore të nën-njësive strukturore 5/24 zona A1, 1/35 zona A2 dhe 9/17 zona A1 (Ndryshim)

Këto PDV, pasi u shqyrtuan nga sektorët e Makroplanifikimit dhe Mikroplanifikimit (Drejtoria e Planifikimit të Territorit/ DPPZHT), rezultuan në përputhje me parashikimet e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë së Tiranës të miratuar me vendimin nr.1 të KKT-së dt 15.02.2013 dhe legjislacionin përkatës, ndaj do të nisë procedura për shqyrtimin administrativ të tyre.